



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:188859
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05634037

CAP.nr.695/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit P.P, nga Klina, rr. "...", nr., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson P.P.1, avokat në Klinë, ndaj debitorit I.H, nga fshati ... Komuna e Klinës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat F.M, nga Klina, objekt i përmbarimit kërkesë në të holla duke vendosur në lidhje me ankesën e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Klinë, CPP.nr.30/22, i datës 19.04.2023, me datë 29.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e kreditorit P.P, nga Klina, rr. "...", nr.12, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë -Dega në Klinë, CPP.nr.30/22, i datës 19.04.2023 ANULOHET dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin CPP.nr.30/22, i datës 19.04.2023, ka vendosur si në vijim: *“REFUZOHET propozimi për lejimin e përmbarimit të kreditorit P.P, nga Klina, Rr. "...", nr.12, i ushtruar me datë 25.07.2022, sipas dokumentit përmbarues –Ujdisë Gjyqësore, C.nr.440/19 e datës 12.10.2021, të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, si i pabazuar”*.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, ankesë ka paraqitur kreditori për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të LPP-së, po ashtu edhe të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën, ashtu që aktvendimin e atakuar ta anulojë, duke i shfuqizuar të gjitha veprimet e kryera të deritanishme përmbarimore apo lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori, përmes të autorizuarit të tij, duke e kundërshtuar në tërësi ankesën e debitorit, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194, 208 dhe 209 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorët kanë paraqitur propozim për përmbaremore me datë 25.07.2022 ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbaremore –ujdisë gjyqësore, C.nr.440/19, i datës 12.10.2021.

Përmbaremore Privat, me urdhrin P.nr.434/22, i datës 25.07.2022, ka lejuar përmbaremoren.

Kundër Urdhrit për caktimin dhe lejimin e përmbaremoren, brenda afatit ligjor prapësim ka paraqitur debitori duke e kundërshtuar në tërësi andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbaremore ose që të caktohet seanca dëgjimore konform nenit 73 të LPP. lidhur me nenin 12 të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e LPP-së.

Gjykata e shkallës së parë me pas shqyrtimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin, CPP.nr.30/22, i datës 19.04.2023, me të cilën e ka refuzuar si të pabazuar propozimin për përmbaremore, më decidivisht si në dispozitivin të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të shkallës së parë gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të propozimit për përmbaremore dhe analizimit të shkresave të lëndës, gjeti se propozimi për lejimin e përmbaremoren duhet të refuzohet si i pabazuar. Kjo për shkak se dokumenti në bazë të cilit është propozuar që të iniciohet procedura përmbaremore konform nenit 22 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore, ashtu siç është plotësuar dhe ndryshuar, tutje referuar si “Ligji për Procedurën Përmbaremore”, edhe pse përbën titull ekzekutiv - dokument përmbaremore, i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbaremore.

Në lidhje me këtë, duhet theksuar se neni 27, paragrafi 1, i Ligjit për Procedurën Përmbaremore shprehimisht përcakton se: “dokumenti përmbaremore është i përshtatshëm për përmbaremore në qoftë se në të janë treguar kreditori, debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbaremoren së detyrimit.” Mbi këtë bazë, është e qartë se në mënyrë që një dokument përmbaremore të jetë i përshtatshëm për përmbaremore, duhet që në mënyrë kumulative të plotësoj të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 27, paragrafin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore dhe atë pa asnjë përjashtim.

Rrjedhimisht, bazuar në kërkesën ligjore të lartpërmendur, dokumenti përmbaremore mbi bazën e të cilit kreditori e ka ushtruar propozimin për lejimin e përmbaremoren në rastin konkret është i pa përshtatshëm për përmbaremore. Kjo sepse në dispozitivin e ujdisë gjyqësore përkatësisht dokumentit përmbaremore nuk është përcaktuar shuma të cilën debitori i përmbaremoren duhet ta

përmbushë ndaj kreditorit të përbarimit por vetëm në mënyrë të përgjithësuar është detyruar debitori që në emër të dëmit të shkaktuar më garazhin e kreditorit të bëjë riparimin e dëmit material i cili është shkaktuar nga veprimet e debitorit në këtë rast gjatë ndërtimit të objektit ndërtimor i cili gjendet në kufi me garazhin e kreditorit kështu debitori është obliguar që të riparoj të gjitha dëmet e shkaktuara ku garazha-kuzhina verore e kreditorit të kthehet në gjendje siç ka qenë, riparimi të bëhej në afat prej një muaj nga dita e lidhjes se kësaj marrëveshje.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata, në rastin konkret, konstatoi se dokumenti përbarimor me të cilin është iniciuar procedura përbarimore në këtë çështje juridike, konkretisht Ujdia Gjyqësore C.nr.440/19, e datës 12.10.2021, e Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Klinë, me të cilin është obliguar debitori që në afat prej 1 (një) muaj, të bëjë riparimin e dëmit material, megjithëse paraqet dokument përbarimor, i njëjti, konform nenit 27 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, nuk është i përshtatshëm për përbarim.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 67 dhe 73 të LPP-së, për çka detyrimisht aktvendimi është dashur të priset.

Gjykata e Apelit gjen se në rastin konkret është vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përbarimore, ashtu që Gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur në lidhje me prapësimin e paraqitur si mjet juridik i rregullt në procedurën përbarimore kështu duke vepruar në kundërshtim me nenin 73 të LPP-së, ku përcaktohet se: *“1. Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përgjithësisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pes (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohet nga Gjykata. 2. Vendimi për prapësim nxirret nga një gjyqtar i vetëm. 3. Me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar.”*

Kjo Gjykatë me rastin e vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe shqyrtimit të aktvendimit të atakuar me ankesë, gjen se Gjykata e shkallës së parë ka marrë rolin e organit përbarues duke e refuzuar propozimin për përbarim, përkundër faktit se në këtë çështje përbarimore është lëshuar urdhri nga Organi Përbarues, P.nr.434/22, i datës 25.07.2022, ndërsa pala debitore ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri, por që nga dispozitivi i aktvendimit rezulton të del se lidhur me prapësimin nuk është vendosur fare, ashtu që urdhri i lëshuar nga përbaruesi privat nuk dihet se a ka mbetur në fuqi apo është shfuqizuar.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e paraqitjes së prapësimit nga ana e palës debitore e ka pasur për detyrim që të marrë vendim në bazë të prapësimit, të vlerësojë se a është lëshuar urdhri përbarimor në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe të vendosë se a duhet të lihet apo jo në fuqi ky urdhër, e jo të refuzojë një propozim për përbarim, pasi që propozimi për përbarim nuk është paraqitur pranë Gjykatës, pra Gjykata nuk ka qenë organ përbarues në këtë rast, por organ përbarues ka qenë Përbaruesi Privat i cili edhe e ka lëshuar urdhrin për përbarim.

Meqenëse u konstatua se ekzistojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përmbartimore, Gjykata e Apelit nuk u lëshua fare në pretendimet e tjera në raport me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale pasi që me shkeljet e konstatuara aktvendimi si i tillë është i pa pranueshëm dhe nuk mund të konsiderohet si i drejtë dhe i ligjshëm, e që këto arsye kanë qar edhe deri te prishja e aktvendimit të ankimuar dhe kthimi i çështjes në procedim të serishëm.

Në ri-procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, ashtu që fillimisht të marrë vendim lidhur me prapësimin e paraqitur nga ana e palës debitoare, të vlerësoj se a përmbushen kushtet e përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore në kuptim të përshtatshmërisë së dokumentit, respektivisht nëse urdhri përmbartimor është lejuar në përputhje me dispozitat e LPP-së, të vlerësojë pretendimet e debitorit në prapësim e në veçanti ti vlerësojë edhe njëherë shkaqet nga neni 71 të LPP-së, e pas kësaj të marr vendim meritor, të drejtë dhe të ligjshëm duke i zbatuar dispozitat ligjore në fuqi. Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në nenin 3 paragraf 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.695/2023, të datës 29.04.2024

Gjyqtarja
Hidajete Gashi Alaj, d.v.